

Intervistë e prezantimit

«Për një vend të hapur për mësim të profesionit pranoj 150 aplikacione, ndërsa pas shoshitjes 120 aplikacione nuk merren parasysh, 30 i shikoj pak më mirë dhe më afër dhe kështu vazhdon tutje. Në fund i kam 5 kandidatët më të mirë sipas meje. Këta 5 i ftoj në intervistë. Zakonisht 3 prej kandidatëve vijnë për praktikë provuese, prej këtyre treve e zgjedhim njërin. Pra, ashpër.»

Daniel Fuchs, diagnostifikues i automobilëve

Ju jeni ftuar në një intervistë prezantuese?

Ky është një sukses i madh!

Megjithatë, ia keni dalë kundër shumë kandidaturave të tjera. Një hap i rëndësishëm drejt vendit për mësim të profesionit. Edhe nëse ju kapur pak trema.

«Nuk guxon të të kaplojë trema e madhe, sa të të kesh gati panik. Duhet të kesh pak vetëbesim. Mendo. Unë mund ta bëj këtë» **Amanda**

Tash ju doni të bëni intervistën me sukses. Me një përgatitje të mirë, rritet edhe vetëbesimi juaj. Çfarë pret trajnuesi profesional apo trajnuesja profesionale prej jush?

«Krejt qartë, përshtypja e parë është e rëndësishme për mua. Paraqitja e personit kur të vijë, si është i/e veshur, unë duhet të kuptoj se ai/ajo ka dëshirë të punojë te ne. Pastaj duhet të shoh, se personi është përgatitur për intervistë. Nëse dikush vjen dhe asnjëherë nuk ka dëgjuar mbi anët e forta dhe anët e dobëta dhe përpara se të përgjigjet i duhet të mendojë gjysmë ore, kjo nuk lë përshtypje të mirë.» **Esther Schüpbach**, Udhëheqëse e arsimit profesional

Si e keni ndërmend të paraqiteni në intervistën për prezantim? Çfarë dëshironi të thoni? Si dëshironi ta thoni?

«Jini i qetë, edhe pse është vështirë. Nervoz janë të gjithë. Mendoni mbi anët e dobëta dhe të forta, kjo pyetje parashtrohet gjithmonë. Dhe, pse e keni zgjedhur këtë profesion apo këtë ndërmarrje. Edhe kjo pyetje parashtrohet gjithmonë. Dhe, shikojeni gjithmonë bashkëbiseduesin tuaj.» **Simone**

Ushtroni intervistën prezantuese

Me kë dëshironi të ushtroni intervistën apo bisedën prezantuese?

Me nënën? Me babanë? Me një të njohur apo të njohurën tuaj? Shumica e të rriturve e dinë se çfarë ndodh gjatë intervistës prezantuese, sepse të gjithë e kanë përjetuar njëherë. Prej këtyre përvojave ju mund të përfitoni. Edhe partneri apo partnerja juaj i/e ushtrimeve duhet të përgatitet: jepjani dokumentacionin e nevojshëm.

- Dosjen e aplikimit, të cilën ia keni dërguar ndërmarrjes
- Dokumentacionin mbi ndërmarrjen dhe profesionin
- Një përgatitje të pyetjeve të mundshme

«Më rëndësi është të thoni të vërtetën. Ti nuk duhet të turpërohesh. Je ftuar për intervistë prezantuese, dhe ky është një hap i madh.» **Céline**

Si dëshironi të ushtroni intervistën prezantuese?

- Ushtroni dy-tri ditë përpara terminimit.
- Merrni kohë. Ndoshta ju duhet një orë, deri sa të funksionojë gjithçka.
- Luteni bashkëbiseduesin tuaj t'ju parashtrojë edhe pyetje të vështira.
- Diskutoni me partnerin tuaj për ushtrime se çfarë duhet të vishni, si dëshironi të paraqiteni.
- Pyetni bashkëbiseduesin tuaj nëse mund t'ju jep këshilla, se si mund të tejkaloni apo zotëroni nervozizmin tuaj.

Mbani mend. Në intervistë prezantuese takoni një njeri, i cili dëshiron të bisedojë me ju dhe ka dëshirë të njihet me ju. Ju takoheni me një njeri, i cili dëshiron të dijë dhe të zbulojë se a përshtateni me ekipin dhe me ndërmarrjen.

«Më i miri shpesh nuk është më i miri vetëm pse ka notat e mira ose mesataren më të mirë të notave. Më i miri është ndoshta ai, i cili përpigjet më së shumti, ka paraqitje të mirë, tregon kënaqësi, është i vëmendshëm, i cili kyçet në ekipin që tashmë ekziston. Në këtë ekip ai do të jetë një pjesë e vogël, dhe ne mendojmë, po, ky është pjesë e enigmës, e cila na ka munguar deri tash. Këtë person e duam.» Daniel Fuchs, diagnostikues i automobilave

Pyetjet të cilat parashtrohen gjatë intervistës prezantuese

Mos u përgjigjini vetëm me po dhe me jo. Nëse dëshironi të nënvizoni se me sa dëshirë punoni në një ekip, atëherë tregoni shembuj nga jeta juaj e përditshme, për shembull si e përjetoni ekipin e klubit tuaj të sportit, te zbuluesit ose te alpinistët. Nëse merrni shembuj nga jeta juaj e përditshme, atëherë i jepni mundësinë bashkëbiseduesit ose bashkëbisedueses tuaj t'ju njohë më mirë.

Pyetjet në fillim të intervistës

- Si ju ka lindur ideja për këtë profesion?
- Si keni vepruar gjatë zgjedhjes dhe përcaktimit të profesionit?
- Çfarë keni ndërmarrë në përgjithësi? Përshkruajeni rrugën e profesionit tuaj.
- A keni bërë praktikë provuese?
- A keni vizituar tubimet informative?
- Keni pasur përkrahje? A ju ka ndihmuar dikush?

Pyetje mbi ndërmarrjen

- Pse keni zgjedhur ndërmarrjen tonë?
- Çfarë bën ndërmarrja jonë?
- Pse mendoni se përshtateni në ndërmarrjen tonë?
- Ju nuk jeni rritur në Zvicër: A e dini se çfarë është me rëndësi në ndërmarrjen tonë?

Pyetje mbi profesionin

- Si dhe pse jeni përcaktuar për këtë profesion?
- A jeni interesuar edhe për profesione të tjera?
- Pse ju pëlqen më shumë ky profesion në krahasim me profesionet e tjera?
- Pse i përshtateni këtij profesioni?
- Nëse tash e bëni mësimin e profesionit: A e dini se çfarë ju pret?
- Nëse mund të përshkruani vendin të cilin e ëndërroni për mësim të profesionit, si do të dukej ky?
- A jeni i përgatitur mirë për shkollën profesionale?
- Për profesionin e duhet të jeni i aftë/komunikues/i saktë/i shkathët në punë dore/ talent për gjuhë etj. (Shih edhe fletëinformative të profesioneve të Qendrës Informative për Profesione). I keni këto shkathtësi?

Pyetjet mbi personin

- Kolegu juaj apo kolegja juaj më e mirë: Si ju vlerëson ai apo ajo?
- Me cilat aftësi tuajat jeni jashtëzakonisht krenar?
- Çfarë mund të bëni mirë?
- Çfarë guxoni të bëni?
- A jeni një person i zgjuar?
- Po të pyesja një shoqe tuajën, se çfarë i pëlqen më së shumti te ju? Çka do të më tregonte ajo?
- M'i thoni tri pikat tuaja më të dobëta.
- Si silleni me dobësitë tuaja? Çfarë mësoni prej tyre?
- Çfarë thoni në lidhje me dëftesën tuaj? A jeni i kënaqur me të?
- Ju keni bërë testin e aftësisë: A jeni i kënaqur me rezultatin e treguar? Çka ka qenë më e vështira? Çfarë ju është dukur e lehtë?
- A flitini edhe gjuhë të tjera?
- Çfarë roli keni në klasën tuaj?
- A keni aftësi të jashtëzakonshme? Cilat? Si i keni arritur këto aftësi?

Pyetje mbi mjedisin

- Si jetoni? Me kë jetoni?
- Keni vëllezër dhe motra? Më të rinj apo më të vjetër? Çfarë bëjnë ata/ato? A kanë mësuar ndonjë profesion?
- Çfarë bën nëna juaj? Po babai juaj?
- Kush i bënë punët e shtëpisë te ju?
- A ndihmoni edhe ju rreth punëve të shtëpisë? Çfarë dini të bëni mirë në amvisëri?
- Me kë flisni së pari, në qoftë se keni ndonjë vështirësi?
- A keni dëshirë që në të ardhmen të keni familjen tuaj?
- A ëndërroni karrierë profesionale? Si duhet të duket ajo?

Fundi i bisedës

Është gjithmonë pozitive, nëse në fund të bisedës parashtroni një pyetje. Gjatë përgatitjes për intervistë prezantuese mund të mendoni, se çfarë dëshironi të pyetni.

- A keni ende ndonjë pyetje në lidhje me ne apo ndërmarrjen tonë?
- Mendoni para bisedës, cilat informata ju mungojnë kur është fjala te mësimi i ardhshëm i profesionit. Shkruani këto pyetje dhe parashtroni ato në fund të bisedës.
- Nëse nuk keni më pyetje, mund të interesoheni deri kur përafërsisht do të informoheni mbi vendimin.
- Theksoni se jeni i interesuar për vendin për mësim të profesionit, se me kënaqësi do të bënit një praktikë provuese, që të keni mundësi të njiheni më mirë me ndërmarrjen.